

SEKSIONI I DYTË
ÇËSHTJA MALO KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 72359/11)

VENDIM

STRASBURG

22 maj 2018

I FORMËS SË PRERË

22.8.2018

Ky vendim është bërë i formës së prerë bazuar në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Malo kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, *kryetar*,

Paul Lemmens,

Ledi Bianku,

Işıl Karakaş,

Nebojša Vučinić,

Jon Fridrik Kjølbro,

Stéphanie Mourou-Vikström, *gjyqtarë*,

dhe Stanley Naismith, *kryesekretar*,

pasi diskutuan me dyer të mbyllura në datën 17 prill 2018,

shpall vendimin më poshtë, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA:

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 72359/11) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë, më 31 tetor 2011, sipas nenit 34, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), nga një shtetas shqiptar, z. Vladimir Malo (“kërkuesi”).

2. Kërkuesi u përfaqësua nga z. S. Luci, një avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti i saj, në atë kohë, zj. L. Mandia, nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesi pretendonte, veçanërisht, se ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

2. Në datën 26 qershor 2012, kërkesa iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Kërkuesi ka lindur në vitin 1975. Aktualisht, ai po vuan një dënim me burgim.

A. Grupi i parë i procedimeve

6. Në datën 9 korrik 2002, pas procedimeve në mungesë, Gjykata e Rrethit Gjirokastër e dënoi kërkuesin për vjedhje me armë mbetur në tentativë, vrasje nga neglizhenca dhe vrasje me paramendim në lidhje me një tjetër vepër penale, dhe e dënoi atë me njëzet e pesë vjet burgim. Edhe tre të bashkëpandehur të tjerë, të cilëve iu pranuan kërkesat për gjykim të shkurtuar, u shpallën të fajshëm. Kërkuesi u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga gjykata.

7. Në datën 7 tetor 2002, pas një apelimi nga tre të pandehurit e tjerë, Gjykata e Apelit Gjirokastër la në fuqi vendimin në mungesë të kërkuesit.

8. Në datën 10 tetor 2007, pas ekstradimit të kërkuesit në Shqipëri, Gjykata e Rrethit pranoi kërkesën e tij për rivendosje në afat. Gjykata e Rrethit, në arsyetimin e saj, parashtroi se shërbimi postar kishte konstatuar se kërkuesi jetonte në Itali dhe për pasojë nuk ishte bërë me dije për dënimin e tij.

B. Procedimet e rigjyimit

9. Në një datë të paspecifikuar, në tetor 2007, kërkuesi paraqiti apelin e tij. Fillimisht, ai kërkoi që çështja e tij të rishqyrtohej veçantë nga ajo e bashkëfajtorëve të tij me arsyetimin se ai nuk kishte kërkuar përdorimin e procedurës së gjyimit të shkurtuar. Ai iu referua vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2, të datës 29 janar 2003 (shih paragrafin 16 më poshtë). Së dyti, ai kërkoi që realizohej një shqyrtim i ri i të dhënave në praninë e tij dhe të pyeteshin disa dëshmitarë. Së treti, ai pohoi se autoritetet nuk e kishin njoftuar në lidhje me procedimet gjyqësore të mbajtura në gjykatën e shkallës së parë.

10. Në datën 17 dhjetor 2007, Gjykata e Apelit Gjrokastër e la në fuqi dënimin në mungesë të kërkuesit. Gjykata vendosi se kërkuesi nuk kishte paraqitur të dhëna të reja për të ndryshuar rezultatin e atyre procedimeve. Kërkesa e tij ishte drejtuar ndaj vlerës provuese të të dhënave, të cilat tashmë ishin shqyrtuar dhe për to ishte marrë një vendim. Për lënien në fuqi të dënimin, gjykata u mbështet në të dhënat mjeko-ligjore të nxjerra në vitin 1997 dhe 1999, si edhe në dëshmitë e dhëna në vitin 2001 dhe 2002. Në vijim, gjykata pohoi se kërkuesi ishte njoftuar rregullisht, sepse autoritetet kishin lëshuar një njoftim publik. Së fundmi, ajo vërejti se procedura e shkurtuar ishte zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë të pandehurit, në përputhje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, të datës 29 janar 2003 (shih më poshtë “Praktika përkatëse gjyqësore vendëse”). Ndarja e çështjeve nuk mund të merrej në konsideratë, sepse gjykata e rrethit nuk kishte marrë një vendim mbi këtë çështje.

11. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesi paraqiti një apel kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Ai u ankua se ishte shkelur e drejta e tij për marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe për rishqyrtimin e të dhënave. Ai theksoi faktin se në apelin e tij Gjykata e Apelit kishte kërkuar marrjen e të dhënave, duke përfshirë paradën e identifikimit, marrjen në pyetje të një personi të katërt, i cili kishte qenë i pranishëm gjatë ngjarjeve, një përballje të drejtpërdrejtë midis tij dhe të bashkëpandehurve të tjerë dhe kështu me radhë. Ai e kishte pasur të pamundur t'i mblidhte vet këto të dhëna; vetëm gjykatat ose prokurori mund ta bënte një gjë të tillë. Gjithashtu, kërkuesi theksoi ankesat e tjera që kishte ngritur gjatë çështjes së tij në Gjykatën e Apelit.

12. Në datën 5 mars 2010, Gjykata e Lartë e pushoi apelin, me konstatimin se i mungonin shkaqet për apel sipas parashikimit të ligjit.

13. Në datën 21 shkurt 2011, kërkuesi paraqiti një apel kushtetues në Gjykatën Kushtetuese.

14. Në datën 9 maj 2011, avokati i kërkuesit u njoftua mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se apelimi i tij ishte i papranueshëm.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDËSE

15. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse në at kohë, për sa u përket procedimeve në mungesë, është përshkruar në detaje në vendimet *Shkalla kundër Shqipërisë* (nr. 26866/05, § § 28–35, 10 maj 2011), dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* (nr. 34783/06, § § 19–42, 5 nëntor 2013).

16. Praktika gjyqësore përkatëse vendëse, në lidhje me realizimin e procedurës së gjyimit të shkurtuar, në kohën konkrete, përshkruhet në detaje në vendimin *Cani kundër Shqipërisë* (nr. 11006/06, § § 34–35, 6 mars 2012).

17. Parashikimet të cilat kanë lidhje me fushën e veprimit të shqyrtimit të një apeli nga Gjykata e Apelit, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit dhe kompetencat e një gjykate apeli, përshkruhen në detaje në vendimin *Mulosmani kundër Shqipërisë* (nr. 29864/03, § 106, 8 tetor 2013).

18. Parashikimet përkatëse në lidhje me procedurën e apelit në Gjykatën e Lartë përshkruhen në detaje në vendimin *Çausb Driza kundër Shqipërisë* (nr. 10810/05, § 53, 15 mars 2011).

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

19. Bazuar në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (a), (b), (c) dhe (d) të Konventës, kërkuesi u ankua në lidhje me gjykimin e tij në mungesë. Po ashtu, ai u ankua se nuk ishte lejuar të shqyrtonte dëshmitë ose të kërkonte shqyrtimin e të dhënave në procedimet e rigjyimit. Këto dispozita parashikojnë si më poshtë:

“1. Në përcaktimin e... çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht... nga [një] ... gjykatë...

...

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) Të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) T'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) Të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) Të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës...”.

A. Pranueshmëria

20. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është qartazi e pabazuar në fakte sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Në vijim, ajo vëren se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

21. Kërkuesi këmbënguli se procedimet ndaj tij kishin qenë të padrejta përderisa ishin zhvilluar në mungesë. Ai nuk ishte njoftuar personalisht për ndonjë akt dhe as nuk kishte marrë ndonjë informacion gjatë hetimit penal dhe procedimeve gjyqësore. Gjatë rigjyimit, gjykatat vendëse nuk kishin mundur të merrnin të dhëna të reja dhe kërkuesi nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe në emrin e tij.

22. Qeveria pranoi se kërkuesi ishte gjykuar dhe dënuar në mungesë. Megjithatë, Qeveria argumentoi se procedimet vendëse nuk kishin qenë të padrejta. U ritheksuan konstatimet e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 17 dhjetor 2007, se kërkuesi ishte njoftuar rregullisht nga autoritetet. Po ashtu, u pohua se ai ishte përfaqësuar nga një avokat i caktuar nga gjykata dhe se të drejtat e tij për mbrojtje ishin respektuar.

23. Në vijim, Qeveria argumentoi se rivendosja në afat ishte një mjet efikas për një gjykim në mungesë, se një përcaktim i ri i akuzës penale u konsiderua një gjykim i ri. Qeveria iu referua neneve 425, 427 dhe 428, të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohej një shqyrtim i apelimit nga Gjykata e Apelit dhe rifillimi i shqyrtimit gjyqësor të një çështje nga Gjykata e Apelit, ku parashikoheshin kompetencat e gjykatës së apelit (shih paragrafin 17 më sipër). Duke u kthyer në çështjen aktuale, u vërejt se ankesat e kërkuesit kryesisht ishin drejtuar drejt vlerës provuese të të dhënave dhe realizimit të procedimeve përpara gjykatës së shkallës së parë. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit, me anë të vendimit të saj të datës 17 dhjetor 2007, kishte vendosur rregullisht mbi meritat e çështjes dhe vlerës provuese të të dhënave. Ajo kishte gjykuar se bazuar në të dhënat e përfutuara gjatë grupit të parë të procedimeve, kërkuesi ishte fajtor për akuzat.

24. Gjykata vëren se parimet e përgjithshme, në lidhje me procedimet në mungesë përshkruheshin në vendimin *Sejdovic kundër Italisë* ([DHM], nr. 56581/00, §§ 81–95, GJEDNJ 2006–II).

25. Më tej, Gjykata thekson se garancitë në paragrafin 3, të nenit 6, janë aspekte specifike të së drejtës për një gjykim të drejtë parashikuar në paragrafin 1. Nën këto rrethana, Gjykata e mendon të panevojshme shqyrtimin e relevancës së paragrafit 3 të çështjes, duke qenë se pretendimet e kërkuesit, në çdo rast, përmblihen në një ankesë se procedimet ishin të padrejta. Për këtë arsye, Gjykata do ta përqendrojë shqyrtimin e saj në këtë pikë (shih *Shkalla*, cituar më sipër, § 67).

26. Në çështjen konkrete, palët nuk debatuan për faktin se kërkuesi u gjykua dhe u dënua në mungesë. Nuk u provua se kërkuesi kishte mjaftueshëm dijeni për procedimet ligjore ndaj tij.

Faktikisht, u konstatua se ai ishte bërë me dije për dënimin në mungesë, pas ekstradimit të tij në Shqipëri (shih paragrafët 6–8 më sipër).

27. Gjykata rithekson se megjithëse procedimet të cilat kishin ndodhur në mungesë të të akuzuarit, në vetvete nuk pajtohen me nenin 6 të Konventës, mohimi i drejtësisë gjithsesi nuk ka dyshim se ndodh në rastin kur një person i dënuar në mungesë nuk mund të përfitojë nga gjykata, e cila e ka dëgjuar, një përcaktim të ri të meritave të akuzës, në lidhje me ligjin dhe faktin, në rastin kur nuk konstatohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u vetëmbrojtur (shih *Sejdovic*, cituar më sipër, § 82). Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata do të shqyrtojë, nëse procedimet e rigjykitimit paraqisnin detyrimin për mundësinë e një përcaktimi të ri faktik dhe ligjor të akuzës penale ndaj kërkuesit.

28. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjirokastrë kishte pranuar pretendimin e kërkuesit për rivendosje në afat, sipas nenit 147 të KPP-së. Në vijim, Gjykata vëren se pas apelimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Gjirokastrë shqyrtoi meritat e çështjes dhe la në fuqi dënimin në mungesë të kërkuesit. Ajo u bazua në të dhënat e marra gjatë grupit të parë të procedimeve. Gjithashtu, Gjykata theksoi se siç mund të vihet re në vendimin e Gjykatës së Apelit, dhe në apeli të kërkuesit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, avokati i kërkuesit kishte paraqitur kërkesa të qarta për një shqyrtim të ri të të dhënave, si edhe të lejohej të merrte në pyetje dëshmitarët. Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk bëri ndonjë përcaktim të ri për akuzat penale ndaj kërkuesit. Gjykata e Apelit konstatoi se kërkuesi nuk paraqiti të dhëna të reja për ndryshimin e rezultatit të procedimeve të mbajtura në mungesë, pa dhënë ndonjë arsye tjetër, çfarëdo, pamundësinë e tij për të mbledhur të dhëna të reja dhe për të thirrur dëshmitarët, siç ishte kërkuar nga kërkuesi (krahaso dhe nxirr ndryshimet *Jones kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 30900/02, 9 shtator 2003, dhe *Makarenko kundër Rusisë*, nr. 5962/03, § 139, 22 dhjetor 2009). Ajo thjesht përsëriti arsyetimin dhe konstatimet në grupin e parë të procedimeve.

29. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi në realitet nuk pati mundësinë të përfitonte një përcaktim të ri të themelit të akuzave ndaj tim nga një gjykatë gjatë procedimeve, mbështetur në garancitë për drejtësi sipas nenit 6.

30. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

II. SHKELJE TJETËR E PRETENDUAR E KONVENTËS

31. Së fundi, kërkuesi u ankua edhe për mungesë të arsyeve në vendimin e Gjykatës së Lartë.

32. Gjithashtu, Gjykata thekson se sipas praktikës së saj gjyqësore të mirë-përcaktuar, reflektimi i një parimi të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të përcaktojnë në mënyrën e duhur arsyet mbi të cilat janë bazuar (shih *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) [DHM], nr. 19867/12, § 84, GJEDNJ 2017; shih gjithashtu *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3783/02, § 105, 18 dhjetor 2007). Shkalla deri ku zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të variojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet sipas rrethanave të çështjes (shih *Garvía Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ 1999–I). Pa kërkuar një përgjigje të detajuar për çdo argument paraqitur nga kërkuesi, ky detyrim presupozon se palët në procedimet gjyqësore mund të presin të marrin një përgjigje specifike dhe eksplicite për argumentet, të cilat janë vendimtare për rezultatit të procedimeve (shih, midis vendimeve të tjera, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, §§ 29–30, seritë A nr. 303–A, dhe *Higgins dhe të Tjerët kundër Francës*, 19 shkurt 1998, §§ 42–43, *Raportet e gjyqësorëve dhe vendimeve* 1998–I). Për më tepër, në çështjet e lidhura me ndërhyrjen në të drejtat e siguruaras sipas Konventës, Gjykata kërkon të përcaktojë nëse arsyet e ofruara për vendimet e dhëna nga gjykatat vendëse janë automatike ose stereotipa të tyre (shih, *mutatis mutandis*, *Paradiso dhe Campanelli kundër Italisë* [DHM], nr. 25358/12, § 210, GJEDNJ 2017 (ekstrakte)).

33. Gjykata vëren se në lidhje me këtë gjë, kërkuesi apeloj në Gjykatën e Lartë me po të njëjtat arsye, si edhe në apelin në Gjykatën e Lartë. Gjykata është e mendimit se arsyet e kufizuara dhënë nga Gjykata e Lartë në formulat *de plano* të vendimeve të saj, gjithsesi tregonin padyshim se kërkuesi

nuk kishte ngritur një nga pikat e ligjit parashikuar nga dispozita përkatëse vendëse, e cila është pranimi i kërkesës së pranueshmërisë për rivendosje në afat (shih paragrafin 18 më sipër). Gjykata vëren se në rastin kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se nuk janë përcaktuar arsyet ligjore për këtë çështje, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih *Marini*, cituar më sipër, § 106).

34. Sipas arsyeve më sipër, rezulton se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazuar në fakte dhe duhet të kundërshtohet sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

35. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

36. Kërkuesi nuk paraqiti pretendim për kompensim të drejtë.

37. Gjykata thekson konstatimet e saj në vendimin *Shkalla* (cituar më sipër, §§ 77–79), dhe *Izet Haxhia* (cituar më sipër, § 70) për faktin se kur një kërkues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij ose të saj, siç garantohet në nenin 6 të Konventës, forma më e përshtatshme e korrigjimit është të sigurohet se kërkuesi është vendosur sa më shumë të jetë e mundur në pozicionin që do të kishte pasur, në rast se do të ishte respektuar ky parashikim. Forma më e përshtatshme e korrigjimit, në parim, do të ishte një gjykim i ri ose një rifillim i procedimeve, në rast se një gjë e tillë do të kërkohej.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *I deklaron* ankesat në lidhje me padrejtësinë e procedimeve në mungesë, të pranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, në datën 22 maj 2018, bazuar në Rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith
Kryesekretar

Robert Spano
Kryetar